



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT TË FONDEVE TË BE
DREJTORIA E STRATEGJIVE TË FINANCAVE PUBLIKE DHE MBËSHTETJES BUXHETORE

TAKIM KONSULTUES

**Për bashkëkrijimin e Planit të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP)
2026–2030**

Datë: 13.03.2026

Ora: 10:00

Vendi: Salla e katit të katërt në Ministrinë e Financave

Minuta të Përmbledhura të Takimit – 13 mars 2026

Takimi konsultues për bashkëkrijimin e Planit të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH/OGP) 2026–2030 u drejtua nga **Znj. Vanina Jakupi, Drejtor në Drejtorinë e Strategjive të Financave Publike dhe Mbështetjes Buxhetore**. Znj. Jakupi cila falënderoi pjesëmarrësit dhe prezantoi rolin e Drejtorisë si koordinuese e angazhimeve të Ministrisë së Financave në kuadër të OGP që prej vitit 2018. Gjithashtu u bë dhe prezantimi i grupit të Punës në Ministrinë e Financave. Ajo theksoi se rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile janë marrë për shqyrtim dhe se qëllimi i takimit ishte diskutimi i mundësive për përfshirjen e tyre në planin e ri.

Përfaqësuesja e Brain Nest Institute, **Znj. Enxhi Lipa**, prezantoi aktivitetin e institutit dhe sugjerimet e dërguara më herët, duke theksuar nevojën për rritjen e transparencës dhe aksesit në informacion mbi projektet dhe fondet publike. Ajo propozoi idenë për krijimin e një Platforme Kombëtare “Open Budget Albania”, si portal i integruar për publikimin e të dhënave buxhetore dhe të projekteve të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë, duke përfshirë vizualizime interaktive dhe një regjistër publik të projekteve.

Z. Ilvis Ballvora, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike, njoftoi pjesëmarrësit se Platforma Kombëtare “*Transparent Albania*” është tashmë funksionale, një iniciativë digjitale kombëtare e nisur nga Qeveria e Shqipërisë përmes Kryeministrit. Platforma u lançua në dhjetor 2024, si rezultat i koordinimit teknik midis AKSHI-t, Ministrisë së Financave dhe MAPA-s (*Ministria e Administratës Publike dhe*

Antikorrupsionit). Qëllimi kryesor i platformës është rritja e transparencës së qeverisë, forcimi i llogaridhënies së institucioneve dhe sigurimi i një akses më të gjerë të qytetarëve në informacionin publik. Platforma është aktualisht në zhvillim të mëtejshëm nën koordinimin e Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Një version paraprak i platformës u krijua dhe është i aksesueshëm që nga fillimi i vitit 2025 me mbështetjen e AKSHI-t, ndërkohë që procesi i përmirësimit të saj dhe i plotësimit me të dhëna vijon në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar funksionalitet të plotë dhe informacion të përditësuar. Në përmbyllje, nga ana e Ministrisë, u theksua gatishmëria për bashkëpunim, dhe adresimi i sugjerimeve pranë strukturave kompetente. Gjithashtu grupi i punës u ftua të përcjellë propozimet e tij lidhur me masat që do të përfshihen në Planin e Veprimit të OGP 2026-2030. U ra dakord që, pas rishikimit të platformës aktuale të transparencës, Brain Nest Institute të ripërcjellë propozimet e tij dhe të vijojë komunikimi. Znj. Lipa falënderoi për mundësinë e përfshirjes dhe u angazhua të dërgojë komente shtesë pas rishikimit të platformës.